



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

RREGULLORE (ZKM) NR. 11/2024
PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E
VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR NDIHMË JURIDIKE
FALAS¹

¹ Rregullore (ZKM) – Nr.11/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas miratuar nga Kryeministri me Vendimin Nr. 101/2024, të datës 27.05.2024

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (10) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 28 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 9 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me nenin 9 paragrafi 7 të Rregullores QRK-Nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura,

Miratton:

RREGULLORE (ZKM) Nr.11/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

Neni 2 Fushëveprimi

1.Kjo rregullore zbatohet për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas si dhe legjislacionit tjetër përkatës në fuqi.

Neni 3 Misioni i Agjencisë

Misioni i Agjencisë është që të ofrojë ndihmë juridike falas duke siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, veçanërisht për grupet e marginalizuara, dhe duke qenë në shërbim të të gjithë atyre që i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj për t'iu ofruar ndihmë juridike falas, veçanërisht duke respektuar parimet e drejtësisë dhe sundimit të ligjit.

Neni 4 Struktura organizative e Agjencisë

1. Struktura organizative e Agjencisë është si vijon:

1.1.Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;

1.2. Departamentet;

1.3. Divizionet;

2. Numri i të punësuarve në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas është pesëdhjetë e shtatë (57) nëpunës.

Neni 5

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv përbëhet nga:

1.1 Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë;

1.2 Stafi profesional;

1.3 Personeli mbështetës.

2. Nëpunësit civil profesional dhe mbështetës në kuadër të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv janë:

2.1. Zyrtari i Lartë Ekzekutiv;

2.2. Zyrtari Administrativ.

3. Pozitat e tjera që i përgjigjen drejtpërdrejtë Drejtorit Ekzekutiv janë:

3.1. Zyrtari i Lartë për Burime Njerëzore;

3.2. Zyrtari i Lartë i Prokurimit, dhe

3.3. Zyrtari i Lartë Certifikues.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë përcaktohen me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv dhe pozitave tjera, përcaktohen me legjislacionin përkatës për zyrtarët publik

6. Numri i nëpunësve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është gjashtë (6) nëpunës.

Neni 6

Departamentet dhe Divizionet e Agjencisë

1. Departamentet dhe divizionet e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas janë:

1.1. Departamenti për Ofrimin e Ndihmës Juridike Falas:

1.1.1. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Prishtinë;

- 1.1.2. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Prizren;
- 1.1.3. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Pejë;
- 1.1.4. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Mitrovicë;
- 1.1.5. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Gjilan;
- 1.1.6. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Ferizaj;
- 1.1.7. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Gjakovë.

1.2. Departamenti Ligjor:

1.2.1. Divizioni për legjislacion dhe

1.2.2. Divizioni për monitorimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas.

1.3. Divizioni për Buxhet dhe Financa, dhe

1.4. Divizioni për Shërbime të Përgjithshme.

Neni 7

Departamenti për Ofrimin e Ndhmës Juridike Falas

1. Misioni i Departamentit për Ofrimin e Ndhmës Juridike Falas është ofrimi i ndihmës juridike falas në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës në pajtim me fushëveprimin e Agjencisë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Ofrimin e Ndhmës Juridike Falas janë:

2.1. ofron ndihmë juridike falas në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, për të siguruar që Agjencia arrin objektivat për sistemin e ndihmës juridike falas;

2.2. drejton dhe koordinon ofrimin e ndihmës juridike falas, duke siguruar se funksionet e caktuara përmbushen në mënyrë efektive, efikase dhe zbatohen brenda afateve kohore;

2.3. kujdeset për zbatimin e politikave dhe rregullave për ofrimin e ndihmës juridike falas, që të sigurojë sistem efektiv, efikas, gjithpërfshirës, fleksibil dhe të qëndrueshëm;

2.4. ofron mbështetje dhe propozon plotësimet dhe ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës juridike falas;

2.5. siguron që ofrimi i ndihmës juridike falas të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2.6. identifikon sfidat dhe mangësitë e legjislacionit për ndihmën juridike falas;

2.7. mban komunikim efektiv dhe koordinon të gjitha funksionet e Agjencinë rreth shërbimeve juridike nga kompetencat e Departamentit.

3. Drejtori i Departamentit për Ofrimin e Ndhmës Juridike falas raporton tek Drejtori

Ekzekutiv.

4. Në kuadër të Departamentit për Ofrimin e Ndhmës Juridike Falas bëjnë pjesë:

- 4.1. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Prishtinë;
- 4.2. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Prizren;
- 4.3. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Pejë;
- 4.4. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Mitrovicë;
- 4.5. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Gjiilan;
- 4.6. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Ferizaj, dhe
- 4.7. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Gjakovë.

5. Numri i të punësuarve në Departamentin për ofrimin e ndihmës juridike falas është tridhjetë e gjashtë (36) nëpunës civil.

Neni 8 **Divizioni Rajonal për Ndhmë Juridike Falas në Prishtinë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Prishtinë janë:

- 1.1. pranimi i kërkesave për ndihmë juridike falas;
- 1.2. angazhimi i ofruesve të ndihmës juridike falas;
- 1.3. ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas në pajtim me autorizimet e përcaktuara me ligj;
- 1.4. mbajtja e evidencës për kërkuesit, përfituesit dhe shërbimet juridike të ofruara;
- 1.5. koordinimi me institucionet lokale për ofrimin e ndihmës juridike efikase;
- 1.6. organizimi i fushatave për vetëdijesimin juridik.

2. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Prishtinë përfshin: Komunën e Prishtinës, Komunën e Podujevës, Komunën e Lipjanit, Komunën e Obiliqit, Komunën e Drenasit, Komunën e Fushë Kosovës dhe Komunën e Graçanicës.

3. Udhëheqësi i Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Prishtinë, raporton tek Drejtori i Departamentit për Ofrimin e Ndhmës Juridike Falas.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin rajonal për ndihmë juridike falas në Prishtinë është shtatë (7) nëpunës civil.

Neni 9
Divizioni Rajonal për Ndhimë Juridike Falas në Prizren

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Prizren janë:
 - 1.1. pranimi i kërkesave për ndihmë juridike falas;
 - 1.2. angazhimi i ofruesve të ndihmës juridike falas;
 - 1.3. ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas në pajtim me autorizimet e përcaktuara me ligj;
 - 1.4. mbajtja e evidencës për kërkuesit, përfituesit dhe shërbimet juridike të ofruara;
 - 1.5. koordinimi me institucionet lokale për ofrimin e ndihmës juridike efikase;
 - 1.6. organizimi i fushatave për vetëdijesimin juridik.
2. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Prizren përfshin: Komunën e Prizrenit, Komunën e Suharekës, Komunën e Dragashit dhe Komunën e Mamushës.
3. Udhëheqësi i Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Prizren raporton tek Drejtori i Departamentit për Ofrimin e Ndhimës Juridike Falas.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin rajonal për ndihmë juridike falas në Prizren është pesë (5) nëpunës civil.

Neni 10
Divizioni Rajonal për Ndhimë Juridike Falas në Pejë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Pejë janë:
 - 1.1. pranimi i kërkesave për ndihmë juridike falas;
 - 1.2. angazhimi i ofruesve të ndihmës juridike falas;
 - 1.3. ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas në pajtim me autorizimet e përcaktuara me ligj;
 - 1.4. mbajtja e evidencës për kërkuesit, përfituesit dhe shërbimet juridike të ofruara;
 - 1.5. koordinimi me institucionet lokale për ofrimin e ndihmës juridike efikase;
 - 1.6. organizimi i fushatave për vetëdijesimin juridik.
2. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Pejë përfshin: Komunën e Pejës, Komunën e Klinës, Komunën e Deçanit dhe Komunën e Istogut.
3. Udhëheqësi i Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Pejë raporton tek Drejtori i Departamentit për ofrimin e ndihmës juridike falas.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin rajonal për ndihmë juridike falas në Pejë është pesë (5) nëpunës civil.

Neni 11 **Divizioni Rajonal për Ndihmë Juridike Falas në Mitrovicë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Mitrovicë janë:
 - 1.1. pranimi i kërkesave për ndihmë juridike falas;
 - 1.2. angazhimi i ofruesve të ndihmës juridike falas;
 - 1.3. ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas në pajtim me autorizimet e përcaktuara me ligj;
 - 1.4. mbajtja e evidencës për kërkuesit, përfituesit dhe shërbimet juridike të ofruara;
 - 1.5. koordinimi me institucionet lokale për ofrimin e ndihmës juridike efikase;
 - 1.6. organizimi i fushatave për vetëdijesimin juridik.
2. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Mitrovicë përfshin: Komunën e Mitrovicës, Komunën e Vushtrrisë, Komunën e Skënderajt, Komunën e Mitrovicës së Veriut, Komunën e Leposaviqit, Komunën e Zveçanit dhe Komunën e Zubin Potok-ut.
3. Udhëheqësi i Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Mitrovicë raporton tek Drejtori i Departamentit për ofrimin e ndihmës juridike falas.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin rajonal për ndihmë juridike falas në Mitrovicë është gjashtë (6) nëpunës civil.

Neni 12 **Divizioni Rajonal për Ndihmë Juridike Falas në Gjilan**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Gjilan janë:
 - 1.1. pranimi i kërkesave për ndihmë juridike falas;
 - 1.2. angazhimi i ofruesve të ndihmës juridike falas;
 - 1.3. ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas në pajtim me autorizimet e përcaktuara me ligj;
 - 1.4. mbajtja e evidencës për kërkuesit, përfituesit dhe shërbimet juridike të ofruara;
 - 1.5. koordinimi me institucionet lokale për ofrimin e ndihmës juridike efikase;
 - 1.6. organizimi i fushatave për vetëdijesimin juridik.

2. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Gjilan përfshin: Komunën e Gjilanit, Komunën e Kamenicës, Komunën e Vitisë, Komunën e Novobërdës, Komunën e Klllokotit, Komunën e Ranillugut dhe Komunën e Parteshit.

3. Udhëheqësi i Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Gjilan raporton tek Drejtori i Departamentit për ofrimin e ndihmës juridike falas.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin rajonal për ndihmë juridike falas në Gjilan është katër (4) nëpunës civil.

Neni 13

Divizioni Rajonal për Ndihmë Juridike Falas në Ferizaj

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Ferizaj janë:

1.1. pranimi i kërkesave për ndihmë juridike falas;

1.2. angazhimi i ofruesve të ndihmës juridike falas;

1.3. ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas në pajtim me autorizimet e përcaktuara me ligj;

1.4. mbajtja e evidencës për kërkuesit, përfituesit dhe shërbimet juridike të ofruara;

1.5. koordinimi me institucionet lokale për ofrimin e ndihmës juridike efikase;

1.6. organizimi i fushatave për vetëdijesimin juridik.

2. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Ferizaj përfshin: Komunën e Ferizaj-it, Komunën e Kaçanik-ut, Komunën e Shtimes, Komunën e Hanit të Elezit dhe Komunën e Shtërpçës.

3. Udhëheqësi i Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Ferizaj raporton tek Drejtori i Departamentit për ofrimin e ndihmës juridike falas.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin rajonal për ndihmë juridike falas në Ferizaj është katër (4) nëpunës civil.

Neni 14

Divizioni Rajonal për Ndihmë Juridike Falas në Gjakovë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Gjakovë janë:

1.1. pranimi i kërkesave për ndihmë juridike falas;

1.2. angazhimi i ofruesve të ndihmës juridike falas;

1.3. ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas në pajtim me autorizimet e përcaktuara me ligj;

- 1.4.mbajtja e evidencës për kërkuesit, përfituesit dhe shërbimet juridike të ofruara;
 - 1.5.koordinimi me institucionet lokale për ofrimin e ndihmës juridike efikase;
 - 1.6.organizimi i fushatave për vetëdijesimin juridik.
2. Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Gjakovë përfshin: Komunën e Gjakovës, Komunën e Malishevës, Komunën e Rahovecit dhe Komunën e Junikut.
 3. Udhëheqësi i Divizionit rajonal për ndihmë juridike falas në Gjakovë raporton tek Drejtori i Departamentit për ofrimin e ndihmës juridike falas.
 4. Numri i të punësuarve në Divizionin rajonal për ndihmë juridike falas në Gjakovë është katër (4) nëpunës civil.

Neni 15

Departamenti Ligjor

1. Misioni i Departamentit Ligjor është ofrimi i shërbimeve juridike dhe shërbimeve të legjislacionit për ndihmë juridike falas si dhe monitorimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas në pajtim me misionin e Agjencisë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit ligjor janë:
 - 2.1. Ofron mbështetje në hartimin e legjislacionit në fushëveprimin e Agjencisë;
 - 2.2. monitoron ofrimin e shërbimeve juridike, duke siguruar që funksionet e caktuara përmbushen në mënyrë efektive, efikase dhe zbatohen brenda afateve kohore;
 - 2.3. kujdeset për zbatimin e politikave dhe rregullave për ofrimin e ndihmës juridike falas, që të sigurojë sistem efektiv, efikas, gjithëpërfshirës, fleksibil dhe të qëndrueshëm;
 - 2.4. siguron që ofrimi i ndihmës juridike falas të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - 2.5. identifikon sfidat dhe mangësitë e legjislacionit për ndihmën juridike falas;
 - 2.6. mban komunikim efektiv dhe koordinon të gjitha funksionet e Agjencisë rreth shërbimeve juridike nga kompetencat e Departamentit.
3. Drejtori i Departamentit Ligjor raporton tek Drejtori Ekzekutiv.
4. Në kuadër të Departamentit Ligjor bëjnë pjesë:
 - 4.1 Divizioni për legjislacion dhe
 - 4.2 Divizioni për monitorimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas.
5. Numri i të punësuarve në Departamentin Ligjor është shtatë (7) nëpunës civil.

Neni 16

Divizioni për legjislacion

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për legjislacion janë:

- 1.1.koordinon aktivitetet me të gjitha strukturat organizative të Agjencisë për zbatimin e legjislacionit;
- 1.2.ofron mbështetje ligjore në hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar;
- 1.3.Ndihmon në hartimin e politikave dhe kujdeset për zbatimin e tyre nga njësitë organizative të Agjencisë;
- 1.4.identifikon problemet e zbatimit të akteve normative;
- 1.5.ofron mbështetje ligjore në hartimin e vendimeve, kontratave, memorandumeve dhe akteve tjera të nevojshme;
- 1.6.koordinon aktivitetet legjislative për Agjencinë me institucionet përkatëse;
- 1.7.mirëmban regjistrin e akteve nënligjore të Agjencisë;
- 1.8.ofron këshilla dhe udhëzime sa i përket ndihmës juridike falas.

2. Udhëheqësi i Divizionit për legjislacion raporton tek Drejtori i Departamentit Ligjor.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për legjislacion është tre (3) nëpunës civil.

Neni 17

Divizioni për monitorimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për monitorimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas janë:

- 1.1.monitoron zbatimin e politikave në fushën e ndihmës juridike falas;
- 1.2.monitoron ofrimin e shërbimeve juridike, duke siguruar se funksionet e caktuara përmbushen në mënyrë efektive, efikase dhe zbatohen brenda afateve kohore;
- 1.3.ofron mbështetje dhe propozon plotësimet dhe ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës juridike falas;
- 1.4. koordinon punën me Odën e Avokatëve të Kosovës, në përcaktimin e masave, për të siguruar përfaqësimin e barabartë të përfituesve potencial të ndihmës juridike falas;
- 1.5.identifikon sfidat dhe mangësitë e legjislacionit për ndihmën juridike falas;
- 1.6.ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve;
- 1.7.verifikon lëndët e avokatëve dhe kujdeset për angazhimin e barabartë të tyre, në drejtim të kompletimit dhe verifikimit të lëndëve;

1.8.harton projekte për aplikim nëpër institucione vendore dhe ndërkombëtare si dhe përcjell implementimin e projekteve;

1.9.harton raporte të rregullta për ofrimin e ndihmës juridike falas.

2. Udhëheqësi i Divizionit për monitorimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas raporton tek Drejtori i Departamentit ligjor.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për monitorimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas është tre (3) nëpunës civil.

Neni 18

Divizioni për Buxhet dhe Financa

1.Divizioni për Buxhet dhe Financa është njësi organizative dhe ka për mision që të merret me çështjet e planifikimit, menaxhimit, shpenzimit të buxhetit që i ndahet Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Buxhet dhe Financa janë:

2.1. përgatit propozimet buxhetore;

2.2. koordinon çështjet buxhetore për të gjitha njësitë organizative të Agjencinë;

2.3. përcjellë dhe raporton mbi ekzekutimin buxhetor;

2.4. siguron që shpenzimet financiare janë bërë në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore;

2.5. menaxhon rezervat e parasë dhe siguron se kontrolli i brendshëm financiar është i bazuar në parimet e llogaridhënies;

2.6. siguron bashkëpunim të ngushtë për përgatitjen e pasqyrave buxhetore dhe financiare.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa raporton tek Drejtori Ekzekutiv.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Buxhet dhe Financa është katër (4) nëpunës civil.

Neni 19

Divizioni për shërbime të përgjithshme

1. Misioni i Divizionit për shërbime të përgjithshme është sigurimi i kushteve për kryerjen e aktiviteteve të Agjencisë përmes ofrimit të shërbimeve logjistike, të teknologjisë së informacionit si dhe shërbimeve tjera mbështetëse dhe logjistike.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për shërbime të përgjithshme janë:

2.1. ofron ndihmë logjistike për personelin e Agjencisë;

2.2. mirëmban pajisjet e teknologjisë informative dhe ofron shërbime të IT-së;

- 2.3. menaxhon me inventarin dhe depot e Agjencisë;
 - 2.4. ofron shërbime sipas nevojave për mallra dhe pajisje të zyrës për punë;
 - 2.5. ofron shërbime të transportit dhe është përgjegjës për mirëmbajtjen e automjeteve të Agjencisë;
 - 2.6. mirëmban dhe administron sistemin e arkivit të Agjencisë;
 - 2.7. ofron shërbime profesionale në aspektin e përkthimit sipas kërkesave të Agjencisë.
3. Udhëheqësi i Divizionit për shërbime të përgjithshme raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.
 4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Shërbime të Përgjithshme është katër (4) nëpunës civil.

Neni 20 Buxheti

1. Agjencia financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
2. Agjencia menaxhon me buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm në pajtim me ligjin në fuqi.
3. Agjencia mund të financohet edhe nga donacione të brendshme dhe ndërkombëtare në përputhje me rregullat dhe procedurat ligjore në fuqi.

Neni 21 Dispozitat përfundimtare

1. Transferimi i stafit në përputhje me legjislacionin për zyrtarët publikë lejohet nëse konsiderohet e nevojshme për rrjedhën e punës.
2. Rritja ose zvogëlimi i numrit të personelit në përputhje me Ligjin për Buxhetin Vjetor nuk krijon nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur krijohen dhe/ose shfuqizohen strukturat organizative.
3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, dispozitat e Ligjit për Buxhetin Vjetor janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.
4. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është Shtojca nr.1 e cila përmban numrin e përgjithshëm të të gjithë të punësuarve në Agjenci dhe numrin e veçantë për secilën njësi, si dhe Shtojca nr.2 e cila përmban organogramin vizual.

Neni 22 Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja nr.06/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.

Neni 23
Hyrja në fuqi

Ky Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

27 Maj 2024

Shtojca Nr. 1: NUMRI I PËRGJITHSHËM I TË PUNËSUARVE NË AGJENCI DHE NUMRI I VEÇANTË PËR SECILËN NJËSI

Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi i përgjithshëm ose i veçantë	Numri/Totali
1. Drejtor i Përgjithshëm	Drejtues i lartë 2	N/A	1
1.1. Zyrtar i lartë ekzekutiv 1.2. Zyrtar administrativ 1.3. Zyrtar i lartë certifikues 1.4. Zyrtar i lartë për burime njerëzore 1.5. Zyrtar i lartë i prokurimit	Profesional 1 Profesional 3 Profesional 1 Profesional 1 Profesional 1	1. Gr. Specialist ligjor 58. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm 3. Gr. Specialist i buxhetit 7. Gr. Specialist i burimeve njerëzore 5. Gr. Specialist i prokurimit publik	1 1 1 1 1
2. Departamenti për ofrimin e ndihmë juridike falas - Drejtor i Departamentit	Drejtues i mesëm	N/A	1
2.1 Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Prishtinë; - Udhëheqës i Divizionit - Zyrtar i lartë për ndihmë juridike	Drejtues i ulët Profesional 1	N/A 1. Gr. Specialist ligjor	1 6
2.2 Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Prizren; - Udhëheqës i Divizionit - Zyrtar i lartë për ndihmë juridike	Drejtues i ulët Profesional 1	N/A 1. Gr. Specialist ligjor	1 4

<p>2.3 Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Pejë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i Divizionit - Zyrtar i lartë për ndihmë juridike 	<p>Drejtues i ulët Profesional 1</p>	<p>N/A 1. Gr. Specialist ligjor</p>	<p>1 4</p>
<p>2.4 Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Mitrovicë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i Divizionit - Zyrtar i lartë për ndihmë juridike 	<p>Drejtues i ulët Profesional 1</p>	<p>N/A 1. Gr. Specialist ligjor</p>	<p>1 5</p>
<p>2.5 Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Gjiilan</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i Divizionit - Zyrtar i lartë për ndihmë juridike 	<p>Drejtues i ulët Profesional 1</p>	<p>N/A 1. Gr. Specialist ligjor</p>	<p>1 3</p>
<p>2.6 Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Ferizaj</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i Divizioni - Zyrtar i lartë për ndihmë juridike 	<p>Drejtues i ulët Profesional 1</p>	<p>N/A 1. Gr. Specialist ligjor</p>	<p>1 3</p>
<p>2.7 Divizioni rajonal për ndihmë juridike falas në Gjakovë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i Divizionit - Zyrtar i lartë për ndihmë juridike 	<p>Drejtues i ulët Profesional 1</p>	<p>N/A 1. Gr. Specialist ligjor</p>	<p>1 3</p>
<p>3. Departamenti ligjor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtor i Departamentit 	<p>Drejtues i mesëm</p>	<p>N/A</p>	<p>1</p>
<p>3.1. Divizioni për legjislacion</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i 			

Divizionit - Zyrтар i lartë ligjor	Drejtues i ulët Profesional 1	N/A 1. Gr. Specialist ligjor	1 2
3.2. Divizioni për monitorimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas - Udhëheqës i Divizionit - Zyrтар i lartë ligjor	Drejtues i ulët Profesional 1	N/A 1. Gr. Specialist ligjor	1 2
4. Divizioni për Buxhet dhe Financa - Udhëheqës i Divizionit - Zyrтар i lartë për buxhet dhe financa - Zyrтар i lartë për zotime - - Zyrтар i lartë për shpenzime	Drejtues i ulët Profesional 1 Profesional 1 Profesional 1	N/A 3. Gr. Specialist i buxhetit Gr.4. Specialist i Ekonomisë Gr.4. Specialist i Ekonomisë	1 1 1 1
5. Divizioni për shërbime të përgjithshme - Udhëheqës i Divizionit - Zyrтар i lartë për teknologji informative - Zyrтар për logjistikë - Zyrтар për arkiv	Drejtues i ulët Profesional 1 Profesional 2 Profesional 2	N/A 19. Gr. Specialist i teknologjisë informative 58. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm 9. Gr. Specialist i arkiv-dokumentacionit	1 1 1 1
Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas			TOTALI: 57

Shtojca Nr. 2 **ORGANOGRAMI**

